




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjenic/Prodato Received/Delivery	22.03.2023	5	viti godina year
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHK/SHK/2880/2023			113



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.382/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.382/2023 të datës 21.02.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.03.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

*Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.382/2023 e datës 21.02.2023 e parashtruar nga ankuesi.

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 21.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1952/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 16.02.2023 me nr.01-120/04-0012896-2/23 të organit të punësimit/Zyrës së Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8) nga hyrja në fuqi e ligjeve të miratuara nga institucionet e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 24.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli, me datë 15.03.2023 përmes emailit ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokoli 2700/2023 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1952/2023 të datës 21.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt emërimi i datës 30.11.2022 me Nr.01-112/01-0106415/22; Përgjigje me shkrim të datës 16.02.2023 me nr.01-120/04-0012896-2/23 të organit të punësimit/Zyrës së Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut; Vendimi A.nr.880/2022 i datës 11.11.2022 me numër protokollit 7048/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 24.02.2023 me numër protokollit 2121/2023; Përgjigje në ankesë e datës 15.03.2023 nga organi i punësimit me numër protokollit 2700/2023 bashkë me shkresat e lëndës; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 24.09.2012; lista e pagave për muajin janar dhe shkurt 2023 dhe Kërkesa për pagesë retroaktive e datës 15.02.2023 me nr.01-120/08-0012896/23.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut në pozitën e punës Inspektor i Shërbimeve Publike. I njëjti më datë 07.10.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për harmonizimin e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8), ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.880/2022 të datës 11.11.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar organin e punësimit që ankuesit t'ia harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga gjashtë (6) në tetë (8), ku si rrjedhojë organi i punësimit, respektivisht Komuna e Mitrovicës së Jugut, më datë 30.11.2022 ankuesit i ka lëshuar Akt Emërimin .Nr.01-112/01-0106415/22 më koeficient tetë (8).

Ankuesi më datë 15.02.2023 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit për periudhën nga Janari 2015 e tutje. Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 16.02.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 15.02.2023 me arsyetimin se koeficienti i pagës tetë (8) do të vlejë vetëm nga data e zbatimit të vendimit të Këshillit.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 16.02.2023 të organit të punësimit, ankuesi me datë 21.02.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e diferencës së dy koeficientëve të pagës në mënyrë retroaktive nga Janari 2015 e tutje.

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së dy koeficientëve të pagës në mënyrë retroaktive, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi me datë 30.10.2012 ka nënshkruar aktin e emërimit për pozitën e punës *Inspektor i Shërbimeve Komunale* me koeficient të pagës gjashtë (6), dhe se i njëjti deri me datë 23.09.2022 nuk ka ndërmarrë asnjë veprim administrativë me qëllim që të rregulloj çështjen që është objekt i këtij kontesti, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohen kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 30.10.2012), përkatësisht nenin 130 paragrafi 1 të këtij ligji ku përcaktohej se: "*Ankimi*

administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin”.

Kolegji i Këshillit duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankuesit kanë për objekt çështjen e realizmit të retroaktivit sa i përket koeficientit të pagës, thekson edhe faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 dhe si rrjedhojë i njëjti ka hy në fuqi nga data 05.02.2023, për më tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil mbi të cilin e bazon edhe pretendimin ankuesi në objektin e kësaj ankese ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 është përcaktuar se gjatë periudhës tranzitore të kalimit në sistemin e ri të pagave, ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave.

Bazuar në at që u tha më lartë dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.382/2023, datë 22/03/2023

Sabile AVDYLI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së